



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 2.06.2014, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Spartak Braho – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Diskutimi nen për nen i projektligjit “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Spartak Braho, Flamur Noka, Arben Çuko, Paulin Sterkaj, Pjerin Ndreu, Luan Rama, Armando Subashi, Ardian Turku, Vexhi Muçmataj, Ulsi Manja, Helidon Bushati, Aqif Rakipi, Keltis Kruja, Astrit Patozi dhe Arben Ristani.

Mungojnë:

Piro Lutaj, Armando Prenga, Shkëlqim Selami, Taulant Balla, Xhemal Qefalia, Arben Ndoka, Anduel Xhindi, Alban Zeneli, Ylli Shehu, Mesila Doda dhe Ermonela Felaj.

Të ftuar:

Gjeneral major Jeronim Bazo - shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të RSH (SHPFA)

Yllka Lamçe - drejtore e Legjislacionit në Ministrinë e Mbrojtjes

Kolonel Nazmi Cahani - drejtor i Planifikimit në SHPFA

Kolonel Fadil Grosha - drejtor i Programimit të Mbrojtjes në SHPFA

Kolonel Idriz Haxhij - drejtor i Operacioneve dhe Stërvitjes në FARSH

Kristo Binjaku - përgjegjës i Sektorit të Legjislacionit në Drejtorinë e Legjislacionit
në Ministrinë e Mbrojtjes

Ismail Shehu - specialist në Drejtorinë e Legjislacionit

Foto Duro – përfaqësues nga Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim.

Shkëlqim Berisha – përfaqësues nga Instituti i Studimeve të Inteligjencës dhe
Sigurisë.

Petrit Zambaku – përfaqësues nga ISKD-ja

HAPET MBLEDHJA

Spartak Braho – Sot në rendin e ditës kemi diskutimin nën për nën të projektligjit “Për karrierën ushtarake dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Kanë ardhur të ftuar nga Ministria e Mbrojtjes Gjeneral- kolonel (nuk e përmend emrin), zonja Yllka Lamçe, kolonel Fadil Grosha, kolonel Idris Haxhiraj, Kristo Binjaku, Ismail Shehu, është njoftuar dhe përfaqësuesi i presidencës, meqë kanë paraqitur edhe ata opsionet e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Është njoftuar dhe nuk ka ardhur.

Helidon Bushati - Një pyetje, zoti kryetar. Meqenëse thatë ju se pritej përfaqësuesi i Presidencës për të dhënë mendimet, a është marrë mendimi i Presidencës për këtë punë?

Spartak Braho – Po është marrë mendimi.

Helidon Bushati - Jo nga ju, desha të pyesja zotërinjtë atje.

Spartak Braho – Po të fillojmë një herë.

Helidon Bushati - Po të na japin përgjigje për një ligj kaq të rëndësishëm, a është marrë mendimi për ligjin “Për karrierën” nga institucioni i Presidentit?

Spartak Braho – Ne e kemi mbaruar diskutimin në parim.

Helidon Bushati - Më falni, zoti kryetar, kjo është procedurale, a është marrë apo jo mendimi i Presidentit?

Spartak Braho – Dakord. Kush do të përgjigjet?

Yllka Lamçe – Përshëndetje! Mendimi i Presidentit është marrë. Ligji “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit të komandimit në Forcat e Armatosura” ka shkuar paketë me ligjet e tjera. Për sa kohë që presidenca është shprehur në atë kontekst, te ligji “Për gradat”, më pas është reflektuar ai mendim, që ka shkuar qoftë për ligjin “Për pushtetet” qoftë “Për gradat”, për ato dispozita, ku është parë e arsyeshme se mund të integroheshin mendimet e Presidencës. Faleminderit!

Helidon Bushati - Nuk mora përgjigje. Ka shkuar në kontekstin e ligjit “Për autoritetet”, dhe jo të ligjit “Për karrierën” ku pika., nuk e di se cili nën është, 25, apo nuk e di, parashikon qartazi pjesën, që janë cenuar kompetencat e Presidentit, prandaj mendoj, që Presidenti edhe me cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura duhej minimalisht, t’i të merrej mendimi për këtë ligj dhe jo për paketën apo për ligjin e “Autoriteteve dhe Pushtetit” në përgjithësi.

Spartak Braho – Tani, ti e shikon që ne ftojmë përfaqësuesin e presidencës dhe ai nuk vjen.

Yllka Lamçe - Nëse mundem, edhe një herë, kompetencat e Presidentit përcaktohen te ligji “Për autoritetet dhe pushtetet e komandimit”. Kështu që për sa kohë është shprehur mbi atë ligj, çdo nen, që më pas është reflektuar edhe në ligjin “Për gradat” për atë që i takon presidentit ka shkuar i harmonizuar me ato mendime që janë pasqyruar.

Helidon Bushati - Së pari, për ta mbyllur këtë diskutim, që u hap, Presidentit të Republikës, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm, i kërkohet mendimi për çdo ligj, që shqyrtohet apo që vjen këtu dhe që ka të bëjë me strukturat e Forcave të Armatosura. Pra, nuk mund të limitohet, që i kemi kërkuar vetëm për ligjin “Për autoritet e komandimit”, sepse tagri i tij si Komandant i Përgjithshëm është më shumë se kaq. Po, për procedurë, zoti Kryetar, përpara se të fillojmë shqyrtimin nen për nen, në mbledhjen e kaluar, unë kam kërkuar, që grupi i punës i Ministrisë së Mbrojtjes, të vërë në dispozicion të komisionit me shkrim oponencën ose ndihmën ose konsulencën që ka bërë me strukturat dhe partnerë të NATO-s për të gjithë paketën e projektligjeve, që kanë ardhur për shqyrtim në komision.

Yllka Lamçe - Edhe diçka lidhur me presidentin, për sa kohë që ne kërkuam mendimin fillimisht “Për autoritetet” dhe “Për pushtetet” te Presidenca në mendimin e parë që dha u shpreh se presidenti shprehet nëpërmjet dekretimit ose jo të ligjeve, dhe në një moment të dytë, kur ligji po depozitohej pranë Këshillit të Ministrave, erdhën disa rekomandime lidhur me ligjin. Kjo reflektoi edhe atë që ndodhi me pjesën tjetër të ligjeve të paketës, që unë përmenda.

Faleminderit!

Spartak Braho - Lidhur me një referim te modelet...

Luan Rama – Më fal, zoti kryetar, unë nuk thashë referim te modelet, se referimin te modelet unë e gjej vetë, marr dhe shoh si e kanë ligjet e vendeve të tjera dhe konsultohem vetë. Unë dua procesin e bashkëpunimit në partneritet të grupit të punës me strukturën përkatëse të NATO-s apo të Pentagonit, me kë janë konsultuar përpara se sa të vijë drafti këtu. Preferencat janë tjetër gjë. Unë kërkoj gjithë procesin e bashkëpunimit dhe konsulencën, mendimet me shkrim që kanë dhënë strukturat partnere dhe që janë dakord me draftet që kanë ardhur.

Spartak Braho – Urdhëroni!

Fadil Grosha – Kolonel Fadil Grosha, drejtor i Programimit të Mbrojtjes.

Për sa i përket konsulencës me vendet e NATO-s, ne jemi vend anëtar i NATO-s, por një konsulencë specifike me ndonjë nga vendet, përveç ligjeve që kanë ata, ne nuk kemi

pasur. Konsulenca ka qenë në formën e takimeve me përfaqësuesit e NATO-s kur kemi pasur rastin që të takohemi. Ndërsa në Ministrinë e Mbrojtjes ne kemi një kompani amerikane private që është kompania “kubik” dhe ato na kanë sjellë mendimet e tyre me shkrim që unë i kam këtu në anglisht, të cilat ne na kanë ndihmuar për të përgatitur draftin që keni ju përpara.

Faleminderit!

Luan Rama – Edhe një herë, zoti kryetar, më lejoni t’ju sjell në vëmendje që në mbledhjen e parë, kur është shqyrtuar në parim projektligji, ministrja e Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm thanë që draftet apo projektligjet që kanë ardhur në komision, si ai për autoritetet dhe pushtetet e komandimit, si ligji për karrierën, si ligji për shërbimin e inteligjencies etj., janë konsultuar me NATO-n dhe kemi rënë dakord. Unë kërkoj këtë proces bashkëpunimi dhe konsultimi me NATO-n.

Më lejoni të shpjegoj, siç është ajo kompania sot, edhe kur kam qenë unë ministër i Mbrojtjes ka qenë një kompani amerikane me të cilën ne punonim në partneritet dhe unë kam kërkuar atë draft që ata e kanë anglisht t’ia vënë në dispozicion komisionit dhe ta shqyrtojmë dhe të shohim sa është i harmonizuar edhe kontributi i kompanisë amerikane që pavarësisht se është kompani private, punon me standardet e NATO-s, në mënyrë që të ndihmojë kjo procesin e diskutimit nen për nen të projektligjit, e para, dhe e dyta, për të hequr çdo mundësi spekulimi apo abuzimi që e ka paraprirë diskutimin e këtyre projektligjeve deri në këtë fazë.

Spartak Braho – Çfarë propozon konkretisht?

Luan Rama – Atë draftin që kanë, të na e vënë në dispozicion dhe të shohim cilat janë rekomandimet që ka dhënë kompania amerikane.

Astrit Patozi – Zoti kryetar, si anëtar i Komisionit të Sigurisë unë kërkoj të informohem se çfarë rëndësie ka për Forcat e Armatosura ky projektligj...

Spartak Braho – E kemi mbaruar diskutimin në parim. Pse nuk vini në mbledhje ju, është tjetër punë.

Astrit Patozi – Një sekondë se nuk kam mbaruar pyetjen, sepse unë shikoj këtu që Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura nuk ka përfaqësues, shikoj që ministri i linjës, ministri i Mbrojtjes nuk është, por edhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave tona të Armatosura prapë nuk është. Ose ky ligj nuk ka asnjë lloj vlere për ushtrinë tonë, ose me ushtrinë tonë ka ndodhur një gjë që ne nuk e dimë dhe të paktën na informoni.

Spartak Braho – Po ju informoj unë, që ministri i Mbrojtjes bashkë me Shefin e Shtabit dhe tërë trupën konsulente ishte prezent në dy raste gjatë diskutimit të ligjit në parim. Komisioni vendosi që të vazhdojë diskutimin nen për nen me specialistë të ministrisë. Komandanti i Përgjithshëm është njoftuar, por nuk ka ndonjë detyrim të vijë këtu në

komision. Kemi marrë vërejtjet e tij dhe do t'i bëjmë objekt shqyrtimi të gjitha këto vërejtje dhe nuk do ta mbyllim mbledhjen e komisionit, pa ardhur përfaqësuesi i Presidencës, kolonel Pirro. Ja ku është edhe kopja e shkresës që i është drejtuar Presidentit dhe sekretarit të Përgjithshëm, zoti Arben Idrizi. Nëse ai shfaq interes dhe nuk paraqitet në mbledhje... ne do të vazhdojmë punën. Nuk do ta mbyllim shqyrtimin e projektligjit, pa hequr të gjitha meraket që kemi ne vetë, ju si opozitë dhe të gjithë ata që janë të interesuar për këtë projektligj.

Flamur Noka - Në diskutimin e këtij projektligji në parim, zonja ministre e pyetur nga kolegu Rama, tha që kanë zhvilluar konsultë me partnerët tanë, kanë zhvilluar konsulta me NATO-n për këtë projektligj dhe për 2 projektligje të tjera që janë në vazhdimësi. Gjithashtu, u tha, që është konsultuar edhe Presidenti i Republikës. Ky i fundit, në shkresën që sapo na u vu në dispozicion thotë: "Ajo që konstatohet në të dy vendimet për miratimin e projektligjeve: projektligjin "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe projektligjin "Për Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes", është anashkalimi i Presidentit si Komandant i Përgjithshëm Forcave të Armatosura, pasi nuk është informuar apo këshilluar për këto iniciativa ligjore. Kjo është shkresa zyrtare që ne si drejtues të komisionit kemi marrë nga Presidenca. Dhe jo vetëm nuk janë këshilluar me Presidencën, por nuk ajo është vënë në dijeni nga Ministria e Mbrojtjes apo nga qeveria për këto dy projektligje kaq të rëndësishme për FA-të.

Ministrja tha që është informuar Presidenti dhe janë konsultuar me të. Ju sapo thatë, që është bërë konsultë pjesore. Cila është e vërteta?

Mu përgjigjini për çështjen e dytë, sepse ministrja tha që kanë zhvilluar konsulta me partnerët dhe me NATO-n për këtë projektligj.

Në seancën e kaluar, ajo i premtoi kolegut Rama se do të sillte informacionet me shkrim në komision. Na sillni informacionet për konsultat që keni bërë me partnerët dhe me NATO-n dhe më pas, të vazhdojmë.

Ju faleminderit.

Ulsi Manja - Zoti kryetar, për procedurë e kërkoja fjalën, sepse po diskutohet shumë nëse jemi konsultuar ose jo, me vendet partnere të NATO-s.

Dua të sqaroj komisionin që Shqipëria është vend anëtar i NATO-s me të drejta të plota. Edhe një herë që duhet të jemi si të barabartë mes të barabartëve, ne në këtë komision po tentojmë t'i themi shtetit shqiptar, që edhe pse jemi vend anëtar i NATO-s me të drejta të plota, ti duhet të vazhdosh të jesh në pozitat e vasalitetit, ndërkohë zotërinjtë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm, thonë se janë konsultuar me partnerët tanë, si vend

anëtar i NATO-s. Nuk mund t'i thuhet një vendi anëtar i NATO-s nëse është konsultuar me anëtarët e tjerë të NATO-s. Sigurisht që po, sepse ne pse jemi vend anëtar i NATO-s me të drejta të plota në një aleancë sigurie, ku funksionojnë konsultimet, shkëmbimet e informacionit, përmirësimet e nevojshme ligjore brenda përbrenda aleancës dhe nuk mund të pyetet: a keni marrë konsulencën nga një vend specifik anëtar i NATO-s?

Unë gjykoj që duhet të bëhemi dinjitozë. Ne jemi vend anëtar i NATO-s dhe sigurisht në kuadër të partneritetit, është në detyrën e shtetit shqiptar të konsultohet me dokumentet strategjike të NATO-s dhe mua më rezulton, që e gjithë paketa ligjore e ka marrë konsulencën e duhur. Zoti Rama thotë të vihen në dispozicion të komisionit konsultimet që janë bërë në kuadër të NATO-s për këto projektligje. S'mund t'i kërkohej ministrisë se me cilin shtet është konsultuar brenda aleancës së NATO-s. Ne jemi vend anëtar i NATO-s dhe s'mund të ulemi tani në këto nivele. Duke qenë vend anëtar i NATO-s ne të sillemi sikur jemi vend në pritje për të hyrë në NATO.

Luan Rama – Më lejoni të sqaroj, zoti kryetar, që konsulenca nuk është vasalitet. Konsulenca është partneritet. Të kërkoresh ndihmë, nuk do të thotë që të cenosh dinjitetin, integritetin apo autoritetin e shtetit shqiptar. Përkundrazi, meqë jemi në një fazë që edhe legjislacionin ta sjellim në standardet e NATO-s, nuk ka asgjë të keqe. Kërkesa ime është e orientuar nga vullneti i mirë për të bërë të mundur që konsulentë të shmangë çdo keqkuptim dhe spekulim që e ka paraprirë këtë shqyrtim, pasi janë disa çështje apo ligje që krijojnë ndjeshmëri.

Pavarësisht se jemi vend anëtar i NATO-s nuk ka pse të na vijë turp të pranojmë që kemi ende shumë mangësi. Nuk ka vend për të krijuar hapësira për komente, interpretime dhe aq më pak spekulime. Edhe vendet e tjera të NATO-s konsultohen me struktura të specializuara. Pa krijuar keqkuptime, jam i mendimit që të vazhdojmë me diskutimin.

Faleminderit!

Flamur Noka – Pa dashur të bëj replikë me Ulsiun, çështja që ngrita unë është: ku janë konsulencat, që javën e kaluar zonja ministre na tha që i ka dhe do të na i paraqesë me shkrim pranë këtij Komisioni. Pra, konsulencat me NATO-n dhe partnerët. Këtu na u paraqit një dokument i një kompanie që është këshilltare e Ministrisë. Është tjetër gjë konsultimi i këtyre tri projektligjeve me NATO-n, që sipas ministres është bërë dhe dokumentuar. Na e paraqisni dhe të fillojmë të diskutojmë. Këto projektligje janë jashtëzakonisht të rëndësishme për karrierën, funksionimin e forcave të armatosura. Si vend anëtar i NATO-s që jemi, rëndësia e tyre merr dimension akoma më të madh. Ndaj kërkojmë që ato të jenë konsultuar me partnerët. Atëherë të diskutojmë nen për nen. Pse? Preken çështje shumë sensitive, jo

vetëm për karrierën, funksionimin e FA-së, jo vetëm për shërbimet inteligjente dhe kompetencat, por çështje sensitive që godasin themelin mbi të cilin është ndërtuar FA-ja.

Ministrja tha që jeni konsultuar. Na i sillni konsultimet.

Presidenti thotë që nuk jeni konsultuar...

Spartak Braho – Duhet të kuptojmë që kemi hyrë në procedurë të shqyrtimit të ligjit nen për nen. Qeveria e ka sjellë ligjin siç është. Nëse nuk ka referenca nen për nen të këtyre parimeve, që i kërkojmë unë apo zoti Rama, sa referohet legjislacioni i NATO-së në dispozitat përkatëse etj., do ta kërkojmë deri në fund, por nuk mund të shmangim shqyrtimin e ligjit nen për nen, sepse kemi hyrë në procedurë. Së dyti, duke qenë se Grupi Parlamentar i PS-së ka mbledhje, do ta shtyjmë këtë shqyrtim për një ditë tjetër.

Flamur Noka – Dakord për shtyrjen. Por ta kenë në konsideratë që të raportojnë pranë Komisionit të gjithë komunikimin me partnerët.

Spartak Braho – Do ta sjellin.

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA